



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Raporti i gjashtëmujorit të parë 2023, për procesin e konsultimit publik, të realizuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

**1. Përmbledhja ekzekutive**

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka realizuar 100% procesin e konsultimit publik, duke konsultuar dhe miratuar projektligjin “Për qeverisjen elektronike”, i cili është objekt i ligjit nr. 146/2014 ‘Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për konsultimin e këtij dokumenti akti janë përdorur metodat e përcaktuara ligjore si publikimi në faqen e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, shpërndarja me e-mail dhe organizimi i takimeve konsultative online.

Operatorë të ndryshëm ekonomik, publiku dhe institucionet shtetërore, patën mundësinë të dërgonin propozimet e tyre lidhur me projektligjin, propozime të cilat janë reflektuar në masën më të madhe.

Projektligji është vizituar nga 1011 vizitorë në faqen online të konsultimit por nuk ka patur komente të dërguara nëpërmjet platformës, që përben dhe një sfidë për tu adresuar në të ardhmën për rritjen e ndërveprimit në regjistrim.

Në referencë me vitet e kaluara, konsultimi publik paraqitet në nivele të njëjta,

**2. Analiza e konsultimeve të kryera**

***2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

***2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?***

Numri i projekt-akteve të miratuara në gjashtëmujorin e parë për vitin 2023 nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ishte 1 (një), konkretisht projektligji “Për qeverisjen elektronike”.

### **2.1.2** *Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?*

Ky projekt-akt i është nënshtruar procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2021 dhe nuk ka asnjë akt të pa konsultuar.

Ndonëse është miratuar në shkurt të vitit 2023, projekt-akti nuk ka pësuar ndryshime ndaj procesi nuk është përsëritur.

### **2.1.3** *Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?*

Projektligji “Për qeverisjen elektronike” i është nënshtruar procesit të vlerësimit të ndikimit.

### **2.1.4** *Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit nuk ka asnjë projekt-akt të planifikuar për miratim në PPAP, PKIE apo dokumentet strategjik sektorial.

### **2.1.5** *Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*

Akti i miratuar në gjashtëmujorin e parë 2023 është 1 (një) projektligj.

### **2.1.6** *A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*

Krahasuar me vitin e kaluar ku AKSHI kishte vetëm një akt për konsultim publik, situata paraqitet e njëjtë.

## **2.2. Metodatat e konsultimit**

### **2.2.1.** *Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për Qeverisjen Elektronike”:

- a) Konsultimet elektronike në faqen zyrtare të konsultimit publik, njoftuar përmes Regjistrimit Elektronik, RENJK
- b) Zhvillimi i një takimi tryeze online me grupet e interesit.
- c) Komunikim elektronik
- d) Komunikim shkresor

### **2.2.2.** *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Komunikimi elektronik si dhe tryezat e organizuara online.

### **2.2.3.** *A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Agjencia Kombëtare e shoqërisë së Informacionit ka realizuar konsultime paraprak për projektligjin e sipërcituar. Tryezat e konsultimit publik me ekspertët janë realizuar nga ana e strukturave përkatëse.

### **2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve**

**2.3.1.** *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Projektligji “Për Qeverisjen Elektronike”, u konsultua në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit, nga 22.10.2021 deri më 19.11.2021, në të njëjtën kohë u zhvillua dhe takimi konsultativ.

**2.3.2.** *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Konsultimi publik ka zgjatur 29 ditë kalendarike

**2.3.3.** *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk paraqet ndryshime

### **2.4. Palët e interesuara të përfshira**

**2.4.1** *Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

Nuk ka patur aktorë të jashtëm të përfshirë në hartimin e projektligjit.

**2.4.2** *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Nuk ka patur aktorë të jashtëm të përfshirë në hartimin e projektligjit.

**2.4.3** *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Gjatë procesit të konsultimit, ishin 10 palë interesi pjesëmarrës në tryezat e konsultimit online, të cilët kanë qenë aktivë duke dhënë sugjerime dhe komente, në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe përmbajtjes së projektakteve. Palët e interesuara të cilët dhanë komente ishin 2.

**2.4.4** *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Për konsultimin e këtij projektakti, pjesëmarrës kontribues ishin 2(dy):

- Vodafon Albania
- Albtelekom

Të cilët komentet dhe rekomandimet e tyre i kanë përcjellë edhe me shkrim (në rrugë zyrtare apo nëpërmjet komunikimit elektronik), pas zhvillimit të tryezave përkatëse.

**2.4.5** *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara paraqitet e njëjtë.


## **2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

### **2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?**

Gjatë procesit të konsultimit janë dërguar 6 komente e sugjerime nga Vodafone Albania me shkresën e datës 22.11.2021 dhe Albtelecom me shkresën e datës 19.11.2021.

### **2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?**

5 komente mbi konfuzionin dhe mbivendosjen e kompetencave me aktet e tyre të brendshme dhe me dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008, janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në gjithë përmbajtjen e projektaktit. 1 koment është refuzuar.



### **2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?**

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara lidhur me shkallën e reagimeve nga palët e interesit është përmirësuar.

### **2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?**

Raporti i vlerësimit të ndikimit nuk është ndryshuar pas konsultimit të aktit.

## **2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

### **2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?**

AKSHI ka hartuar dhe publikuar në portalin e regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK) raportin e konsultimit për një projektligjin "Për Qeverisjen Elektronike".

### **2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?**

Nuk ka asnjë akt nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit pa u publikuar.

**2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik** (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Institucioni vlerëson se konsultimi i këtij projektakti ka qenë në nivel shumë të mirë. Për këtë projektakt janë përdorur disa metoda të konsultimit publik përkatësisht, publikimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, njoftimi me email, tryeza të konsultimit me ekspertë/takime online.

**3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** (*Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?*)

Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik.